

07/10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBER
DREJTORIA PPECK**

Nr.3260/1 prot.

Peshkopi, më 11. 09. 2025

PROJEKT - VENDIM

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”**, **Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “**, **Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”**, **VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç, në mbledhjen e tij,**

VENDOSI :

- I. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
- II. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **apartament banimi ne kat te trete** në pronësi të **Z. Zonun Fishti** Njësia Administrative Peshkopi në shumën totale **9,348,829** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **9,013,029** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **335,800** lekë.
- III. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **4,674,414.5** lekë (50 % të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

PËR BASHKINË DIBËR

DREJTORIA E PPECK

Nexhat FETA



DREJTORI EKONOMIK

Çeljeta ZUNA



DREJTORI I DREJTORISE JURIDIKE

Ismet SARACI



KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

PROCES-VERBAL KONSTATIMI

I mbajtur sot me date **02.09.2025**, ne Njesine Administrative Peshkopi, ne Lagjen Nazmi Rushiti, ne banesen e **Z.ZONUN FISHTI**, mbi verifikimin e kërkesës së tij drejtuar Bashkise Dibër me **nr. 3260** prot. date **27.08.2025**, lidhur me zjarrin e rene me **dt. 27.08.2025**.

Ne zbatim te VKM se nr 329 date 16 05 2012 (Për kriteret dhe procedurat e dhënies se ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtari njerëzore), **kreu III, pika 1, germa b** si dhe në zbatim te Urdhërit te Kryetarit te Bashkise **nr. 389** Prot. datë **27.08.2025**, për ngritjen e komisionit për verifikimin e pasojave të shkaktuara nga zjarri i rene ne banese me **dt. 27.08.2025**, ku ky komision përbëhet nga ana e kryetarit Ing Edvin SHAHI si dhe anëtarët Ilir KACNIA dhe Mentor LLESHI.

Nga verifikimi ne vend i objektit nga komisioni u konstatua se : disa elemente te baneses me **mur tulle**, si **catia** e mbuluar me **tjegull marsejeze**, **traret** prej beton armeje **suvaja e brendshme** e mureve me grafiato dhe tavanit të katit te trete, **suvaja e jashtme** e fasades me grafiato, **muret anesore** dhe **te brendshme** prej tulle, **shkallet e brendshme** prej beton armeje dhe **veshje mermeri**, „**tavani**“ i katit te trete prej gipsi, **dyert e brendshme** prej druri dhe **dera e jashtme** e blinduar, **dritaret** prej duralumini dopio xham+davancialet, **rrjeti i brendshem i ujesjellesit**, **pajisjet elektro shtëpiake** ne të kater dhomat, ne korridor, ne depo dhe WC, **parapetet e shkalleve** dhe ballkonit, **dyshevoja e katit te trete+shtresa** bashke me **pllake porcelanat**, **WC me shtrese dhe veshje pllake porcelanat**, **oxhaku** i hollit janë të dëmtuara nga veprimtaria natyrore e llojit zjarr si shkak i shkëndijës elektrike, gjithashtu jane demtuar plotesisht dhe mobiljet qe do permendim me poshte si: **bufeja**, **divanet**, **dhome gjumi**, **portmonto**, **karrige te zakonshme**, **tavolinat e televizorit**, **e sallanit dhe e bukes**, **televizor**, **frigorifer**, **lavatrice**, **kondicioner**, **kompjuter**.

Dëmtimet nga veprimtaria natyrore e llojit zjarr janë në brendësi të banesës, dhe I gjithe konstrukti i brendshëm ne katin e trete bashke me depon, pra e gjithe struktura e objektit ka dale jashte funksionit.

Dëmtimet e mesiperme evidentohen nga fotot e bëra në vend.

Per te percaktuar dhe parandaluar eliminimin e metejshe me rrezikut te degradimit te elementeve te kesaj ndertese eshte e domosdoshme te merren **masa parandaluese** te tipit nderhyrje ne elementet e demtuar sipas preventivit qe do te hartohet nga grupi i eksperteve, pra te behen nderhyrjet per riparim demi sipas projekt- preventivit bashkengjitur ketij proces -verbali

Ky proces verbal mbahet ne 5 kopje dhe nenshkruhet nga komisioni.

KOMISIONI I VERIFIKIMIT

Kryetar

Edvin SHAHI

Anetar

Ilir KACNIA

Anetar

Mentor LLESHI

Kërkes

KSHKOP Dato 27/08/2025

UNE ZONË FISHI' MENI D H00418005 L.

LINDUR me dat 18/04/1970.

3260

27/08/25

Bonus në lagjen NOEMI RUSHI

(Bashkia dhe parages këte kërkes

Se më është dhënë SHËRPIA ku uhe borge

Me të gjithë orendit brenda

Lu tem që kërkes të meret në konsiderat

Zonë FISHI'



0683471567

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Zonun FISHTI	Hashim	Merieme	M	Kryefamiljar Bashkëshorte	18-04-1970	I/e martuar	Vranjt, Diber	Shqiptare	H00418005L
2.	Afrime FISHTI	Liman	Zare	F		17-03-1970	I/e martuar	Deshat, Diber	Shqiptare	H05317172V
3.	-----									
4.	-----									
5.	-----									
6.	-----									
7.	-----									
8.	-----									
9.	-----									
10.	-----									

Kjo certifikatë lëshohet për _____



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e
Përgjithshme e Gjendjes Civile
Data: 2023/08/27 14:36:26 +02'00"
b0e7bd47b54a430d912bcebb0eb093d4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2932024225

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2932, Lloji i Pasurisë: APARTAMENT, Nr. i Pasurisë: 12/24+1-9, Sipërfaqja Totale 171 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale PE-E,F-3,4, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia PESHKOPI, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 8379000 Leke (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: Zonun Hashim Fishti, Nr. Identifikimi/NIPT H00418005L, Pjesa Takuese 1/2, Lloji i Pronësisë: B

Adresa e Pronarit: Bashkia PESHKOPI, Rruga PESHKOPI, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Pronari: Afrime Liman Fishti, Nr. Identifikimi/NIPT H05317172V, Pjesa Takuese 1/2, Lloji i Pronësisë: B

Adresa e Pronarit: Bashkia PESHKOPI, Rruga PESHKOPI, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 00018781, Datë: 05/05/2020

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



BASHKIA DIBËR
FATURË PËR ARKËTIM

Nr.22

Data 27.08.2025

Me anë të kësaj fature kërkohet që Banka juaj të pranojë nga klientë (persona/persona fizik/persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit Përfutues:
Kodi i Institucionit Përfutues.
Kodi i Degës Thesarit ku vepron.
Emri i pagesit (person fizik/ juridik)
Numri i Identifikimit të pagesit

BASHKIA DIBËR
2106001
0606

Zenuna Flishi

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që Arkëtohet (Lekë)
	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	
1	Vërtetim zjarri	7113011	1 000 (Njëmijë)
	TOTALI		1 000 (Njëmijë)

Përfaqësuesi i Institucionit

DREJTORIA E MZSH-së

KLIENTI
(Person Fizik/Juridik)

Zenuna Flishi

MIRATOHET
BASHKIA DIBER
KRYETARI
RAHIM SPAHIU



Projektuesi: Ing.Edvin SHAHI

Objekti: RIKONSTRUKSION APARTAMENTI
 ZONUN FISHTI

Datë: 08-09-2025

PREVENTIV

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
1. PUNIME SHITESASH 2						
1	2.262/1	Shtrese betoni C 7/10	m3	28.0	13,408.21	375,429.75
2	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat	m2	170.0	4,131.15	702,295.50
Shuma 1:						1,077,725.25
2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI						
3	2.324a	Plintuse pllake grez	ml	112.0	386.88	43,330.45
4	2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	544.0	801.86	436,212.94
5	2.308/a	Suvatim me grafiato h > 4 m	m2	112.0	2,167.54	242,764.14
6	2.297/b	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	m2	176.0	3,348.97	589,419.06
7	2.358/b	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	m2	135.0	4,688.37	632,930.25
8	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	68.0	3,323.30	225,984.33
Shuma 2:						2,170,641.17
3. PUNIME BETONI DHE B/A						
9	2.119/1a	Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m	m3	12.0	27,360.49	328,325.90
Shuma 3:						328,325.90
4. PUNIME HEKUR BETONI						

10	2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	2.0	128,911.85	257,823.70
Shuma 4:						257,823.70
5. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE						
11	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	38.0	1,432.10	54,419.88
12	2.220	Çati me kapriate metalike me HD 10~12m, mbuluar me plastmas te valezuar	m2	242.0	3,271.96	791,814.30
Shuma 5:						846,234.18
6. PUNIME MURATURE TULLE						
13	2.70/2	Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25	m3	52.0	17,600.52	915,227.04
Shuma 6:						915,227.04
7. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT						
14	1.117/p1	Bazamak shkalle me granil	m2	9.0	2,556.82	23,011.34
15	1.117/p	Pragje dritare me granil	m2	26.0	2,454.37	63,813.57
Shuma 7:						86,824.91
8. PUNIME DYER DRITARE						
16	2.375/2a	Dritare d/alumini dyli xh.	m2	12.0	11,649.23	139,790.80
17	2.383/1	F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re.	m2	18.0	21,650.85	389,715.38
18	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m2	8.0	11,760.94	94,087.54
19	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	4.0	44,441.55	177,766.22
Shuma 8:						801,359.93
9. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE						
20	2.491/d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16	ml	96.0	535.87	51,443.14
21	2.491/2h	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=110mm, t = 8.1 mm, Pn 10	ml	46.0	1,578.56	72,613.94
22	2.494	F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm	copë	6.0	1,175.50	7,052.99

23	2.495	F.V. Lavaman porcelani	copë	2.0	11,653.46	23,306.92
24	2.498	F.V. Lavapjate	copë	2.0	12,408.39	24,816.78
25	2.501	F.V. WC allafrenga	copë	2.0	16,713.47	33,426.93
26	2.506	F.V. Bide porcelan	copë	2.0	7,484.37	14,968.74
27	2.508	F.V. Bolier 100 l	copë	2.0	12,885.43	25,770.85
Shuma 9:						253,400.29

10. INSTALIME PER NDRICIM

28	2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	134.0	222.00	29,747.60
29	2.487/b	F.V. Kutit suport pllaket 4 mod	copë	6.0	443.71	2,662.25
30	2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	82.0	44.55	3,653.43
31	2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	178.0	61.41	10,930.27
32	2.481/3	F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml	26.0	72.24	1,878.21
33	2.485	F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	20.0	788.83	15,776.50
34	2.486	F.V. Portollampa norm 10 A	copë	20.0	374.88	7,497.56
35	2.489	F.V. Siguresa ~ 25 A	copë	12.0	506.24	6,074.92
36	2.485/d	F.V. Priza shuko universal	copë	48.0	788.83	37,863.60
37	2.457	F.V. Ndricues fluoreshent 1x18w,IP65	copë	20.0	1,392.30	27,846.04
38	2.490/1e	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A	copë	4.0	5,191.20	20,764.80
39	2.466	F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x40w	copë	8.0	2,725.65	21,805.22
Shuma 10:						186,500.40

11. PUNIME BOJATISJE

40	2.410/a	Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm	ml	25.0	7,245.37	181,134.25
Shuma 11:						181,134.25

12. ANALIZA JASHTE LISTE


41	Anmateria	depozite uji	cifl	2.0	24,000.00	48,000.00
Shuma 12:						48,000.00

Shuma Analiza**7,153,197.40****Fondi Rezervë (5.0%)****357,659.87**

Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)	7,510857.27
TVSH (20%)	1,502,171.45
Shuma me TVSH	9,013,028.72
Totali	9,013,028.72

Preventivuesi:

Ing. Edvin SHAHI



Shënime:

ESHTË PËRDORUR PORTALI "SISTEMI I INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË CMIMEVE PËR ZERAT E PUNIMEVE NË NDERTIM.

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISE

Rahim SPAHIU

PREVENTIV

Objekti: Vlersimi i orendive e paisjeve elektroshtepiake ne banesen e djegur te

Z.Zonun Fishti

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Sasia	Cmimi (lek)	Vlera (lek)
1	Tavoline e zakonshme salloni	Cop	1	6000	6000
2	Karrike zakonshme	'	6	1300	7800
3	Tavoline televizori	"	1	7000	7000
4	Portmonto	"	1	10000	10000
5	Dhome gjumi	kmp	1	61000	61000
6	Tavoline buke	Cop	1	6000	6000
7	Divane	"	3	10000	30000
8	Bufe guzhine	"	1	30000	30000
9	Televizor	"	1	37000	37000
10	Frigorifer	"	1	55000	55000
11	Lavatrice	"	1	36000	36000
12	Kondicioner	"	1	34000	34000
13	Kompjuter	"	1	16000	16000
	SHuma				335800

Mbyllet me nr rendor 13 (trembedhjete)

Vleresimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektro-shtepiake te demtuara eshte bere mbi bazen e cmimeve aktuale te percaktuara nga DPT. Me shkrese nr 20/1 prot date 11.01. 2022 te Prefektit te Qarkut Diber


Peshkopi me date 02 . 09 2025

Preventivoi

Ilir Kacnia



PLANIMETRIA E Z.ZONUN FISHTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin

V Ë R T E T I M

PËR RËNIE ZJARRI

Vërtetohet se me datë 27/08/2025, në objektin APARTAMENT BAHIMI, KATER DHOMA PLUS
Me pronar z.zj. ZONUN FISATI, ka rënë zjarr. SALLON PRITJE

Si pasojë e zjarrit të rënë janë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale si : ESHTË DJEGUR
TERESISHT APARTAMENTI ME KATER DHOMA SALLON PRITJE ME TË GJITHA
MATERIALET DHE ORENTITË SHTRËPIAKË BRENDA.

Për fikjen e zjarrit ka marrë pjesë personeli i stacionit të shërbimit MZSH-së Dibër

i turnit I, me komandant turni ABEDIN HORESHKA

dhe automjeti zjarrfikës me targë DI 3182A, në datë 27/08/2025.

Nga ndërhyrja u bë e mundur të LI SHPETUAM KATER F TJERA TE PALLATIT
KATER KATESH SI DHE NDERTESAT E TJERA QE ISHIN SHUMË AFËR

Stacioni MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që vërteton rënien e zjarrit.

Ky vërtetim mbahet në 3 (tre) kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarit për ta përdorur sipas nevojës.

K R Y E T A R

DREJTORI I SHËRBIMIT MZSH-së

Drejtues Zjarrfikës Fafos GJOKA

ANËTAR


PËRGJEGJËSI SHËRBIMIT

ANËTAR

SHËFI I SEKTORIT TË NDËRHYRJEVE

- ABEDIN HORESHKA -

- LATIF ALIKLI -



REPUBLIKA E SHOIPERISE

**BASHKIA DIBER
DREJTORIA PPECK**

Lënda : Relacion shpjegues në lidhje me vlerën e dëmeve të llogaritura të banesës për Z.Zonun Fishti.

Për Këshillin Bashkiak Diber

Bazuar në ligjin 139/2015 “ *Për Vetqeverisjen Vendore*”, ligjin 45/2019 “ *Për Mbrojtjen Civile*”, VKM nr. 329/2012 “ *Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*”, për rastin e djegies së banesës Z.Zonun Fishti Njësia Administrative Peshkopi, ju sqarojmë se është verifikuar rasti nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Diber, janë bërë matjet e duhura, është bërë fotografimi i objektit brenda e jashtë, është bërë vlerësimi i dëmit në përputhshmëri me kërkesat e VKM nr. 629/2015 “ *Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*” dhe EKB (dokumentit të sjellë nga Ministria Brendshme me nr 5163 prot datë 14. 08. 2017 protokolluar në bashki me nr 3891 prot datë 17. 08. 2017 “ *Çmimet mesatare sipas zërave të punës*”) si dhe listës së çmimeve të orendive e pajisjeve elektroshtëpiake të sjella nga Institucioni Prefektit Qarkut Diber me nr. 20/1 datë 11. 01. 2022, protokolluar në bashki me nr. 24/1 datë 13. 01. 2022 dhe ka si dokument shoqërues shkresën e sjellë nga Ministria Brendshme me nr. 565/8 datë 12. 05. 2016 “ *Çmimet aktuale mesatare të mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria Përgjithshme e tatimeve*” .

Dokumentacioni tekniko – ligjor është bashkëlidhur në dosje bazuar në VKM nr. 329/2012 “ *Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTORIA PPECK

Neihat Feta

Peshkopi 10. 09. 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.887/1 prot.

Peshkopi, më 13.10.2025

Lënda: Kthim vendimi për rishqyrtim.

BASHKISË

DIBËR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikoi ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.58 (pesëdhjetë e tetë) datë **01.10.2025**, për trajtim me ndihmë shtetërore financiare të qytetarit banesa e të cilit është dëmtuar nga faktorët natyror apo njerëzor, **konstatova se:**

-Në zbatim të ligjit nr.45 datë 18.07.2019, "Për Mbrojtjen Civile", të kërkesave të kreut III, pika 3, shkronja ç të VKM nr.329 datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" ku përcaktohet se : Masa e ndihmës financiare është vetëm 50 % e vlerës së dëmit, pa përfshirë vlera të shtuara nga fondi i veçantë dhe tvsh, pasi subjekti përfitues nuk është tatimpagues i regjistruar si deklarues TVSH-je.

-Nuk ka përputhshmëri të disa strukturave të përcaktuara në Procesverbalin e Konstatimit në vlersim me strukturat ndërtimore preventive.

-Relacioni shpjegues nuk referon historikun e ngjarjes së ndodhur dhe bazën ligjore që duhet, por është plotësuar me bazë ligjore me vlersim dëmi sipas VKM nr.629/2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", ndërkohë vlersimi i dëmit është bërë sipas munualit të çmimeve sipas VKM nr. 216, datë 13.4.2023, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

Për këto arsye vendimi nr. nr.58 (pesëdhjetë e tetë) datë **01.10.2025**, kthehet për rishqyrtim duke kërkuar reflektimin e organit vendor në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 58 Datë 01/10/2025

“Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të ligjit nr.139.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.107 datë 22.10.2016 “Për prefektin e Qarkut”, ligjit nr.45 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **01.10.2025**, me 20 vota pro, 0 kundër dhe 2 apstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin apartament banimi në kat të tretë në pronësi të Z.Zonun Fishti, Njësia Administrative Peshkopi në shumën totale 9,348,829 lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlerë e dëmit ndërtimore 9,013,029 lekë dhe vlera e dëmit orendiak 335,800 lekë.
3. Nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **4,674,414.5** lekë (50% të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall me datë **01.10.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak

